URDHËR
Nr.123, datë 22.12.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR INTEGRIMIN NË NJË BAZË QENDRORE TË INFORMACIONIT PËR NGJARJET NË AVIACIONIN CIVIL DHE SHPËRNDARJEN E KËTIJ INFORMACIONI TE PALËT E INTERESUARA

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 104 të ligjit 10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit", si dhe në përputhje me urdhrin nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për integrimin në një bazë qendrore të informacionit për ngjarjet në aviacionin civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

RREGULLORE
PËR INTEGRIMIN NË NJË BAZË QENDRORE TË INFORMACIONIT PËR NGJARJET NË AVIACIONIN CIVIL DHE SHPËRNDARJEN E KËTIJ INFORMACIONI TE PALËT E INTERESUARA

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore parashikon masat për integrimin në një bazë qendrore të informacionit që lidhet me ngjarjet që ndikojnë në sigurinë ajrore dhe që shkëmbehet nga autoritetet kompetente shqiptare me shtetet anëtare të ZPEA-së, në përputhje me urdhrin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil" dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara, me qëllimin për t'u siguruar këtyre palëve, informacionin e nevojshëm për të përmirësuar sigurinë ajrore në aviacionin civil.

Neni 2
Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:
1.1 "Palë e interesuar" nënkupton çdo person fizik ose juridik, që është në pozitë për të marrë pjesë në përmirësimin e sigurisë ajrore në aviacionin civil, duke pasur akses në informacionin mbi ngjarjet, në përputhje me neni 6/1 të urdhrit të ministrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil" dhe që përfshihet në një nga kategoritë e palëve të interesuara, të listuara në aneksin I të kësaj rregulloreje.
1.2 "Pikë kontakti" nënkupton:
a) autoritetet kompetente sipas nenit 5/1 të urdhrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores

për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil";

b) Komisionin Europian.

Neni 3

Baza e informacionit

1. Autoritetet kompetente shqiptare krijojnë një bazë të dhënash kombëtare mbi raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil të lidhura me sigurinë ajrore, për informacionin e mbledhur në bazat e të dhënave të tyre, siç parashikohet në nenin 5/2 dhe 5/3 të urdhrit të ministrit nr.68, datë 10.6.2011. Informacioni që përmban baza e të dhënave kombëtare, do të transferohet në bazën qendrore të informacionit, të krijuar dhe menaxhuar nga Komisioni Europian.

2. Autoritetet kompetente shqiptare duhet të bien dakord me Komisionin për protokollet teknike për përditësimin e bazës qendrore të informacionit, duke transferuar të gjithë informacionin përkatës, lidhur me sigurinë ajrore, që mbahet në bazën e të dhënave kombëtare. Kjo do të sigurojë që i gjithë informacioni përkatës, lidhur me sigurinë ajrore, që mbahet në bazën e të dhënave kombëtare, t'i bashkohet bazës qendrore të të dhënave.

3. Në përputhje me urdhrin e ministrit nr.68 datë 10.6.2011, çdo organ përgjegjës për aspektin rregullator të sigurisë ajrore në aviacion ose për hetimin e aksident-incidenteve, në aviacionin civil brenda ZPEA-së, do të mund të njihet *online* me të gjithë informacionin që përmban baza qendrore e të dhënave, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, përveç informacionit që identifikon direkt operatorin ose avionin subjekt të raportimit të ngjarjes.

4. Informacioni që mbetet konfidencial është emri, firma, shenja ose numri i fluturimit të operatorit, marka e regjistrimit ose numri serial i avionit. Në rastet kur ky informacion konsiderohet i nevojshëm për analizimin e sigurisë ajrore, duhet të kërkohet autorizim nga ai shtet i ZPEA-së, i cili ka dhënë informacionin.

Neni 4

Informacioni lidhur me hetimet

Informacioni bazë mbi aksidentet dhe incidentet serioze duhet transferuar në bazën qendrore të të dhënave të Komisionit Europian, ndërkohë që investigimi është akoma në proces. Kur investigimi përfundon, duhet të shtohet në bazën qendrore i gjithë informacioni, përfshirë, kur është e mundur, edhe një përmbledhje në anglisht të raportit të hetimit përfundimtar.

Neni 5

Rishikimi

Autoritetet kompetente duhet të rishikojnë çdo vit lidhjen e ngjarjeve të sigurisë ajrore me të dhënat e ruajtura dhe të shkëmbyera.

Neni 6

Kërkesat për informacion

1. Palët e interesuara, që janë persona fizikë, të themeluara në ZPEA, të listuara sipas aneksit I të kësaj rregulloreje, duhet të adresojnë kërkesat për informacion pranë pikave të kontaktit të atij shteti, ku ata janë të licencuar ose kur nuk kërkohet licencë, të atij shteti ku ata ushtrojnë funksionet e tyre.

2. Palët e tjera të interesuara, të themeluara brenda ZPEA-së, duhet t'ua adresojnë kërkesat për informacion pikave të kontaktit të atij shteti ku ata kanë zyrë të regjistruar ose vendndodhjen zyrtare (selinë) ose në mungesë të tyre, vendndodhjen kryesore të biznesit të tyre.

3. Palët e interesuara, të themeluara jashtë ZPEA-së, duhet t'ia adresojnë kërkesën e tyre Komisionit Europian.

4. Lista e pikave të kontaktit botohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

5. Kërkesat duhet të dorëzohen duke përdorur formularët e miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Neni 7
Kërkesat speciale

Çdo palë e interesuar, që ka dorëzuar një raport të veçantë, mund t'ia adresojë kërkesën për informacion lidhur me atë raport, drejtpërdrejt pikës së kontaktit që e ka marrë raportin.

Neni 8
Vlerësimi i kërkuesit

1. Pika e kontaktit që merr një kërkesë duhet të kontrollojë që ajo të jetë bërë nga një palë e interesuar.
2. Nëse një palë e interesuar i adreson një pike kontakti, një kërkesë jashtë fushës së kompetencave të saj, atëherë palës së interesuar i sugjerohet të kontaktojë pikën e kontaktit kompetente.

Neni 9
Vlerësimi i kërkesës

1. Pika e kontaktit që merr një kërkesë duhet ta vlerësojë atë rast pas rasti, nëse kërkesa është e justifikuar dhe e argumentuar.
2. Nëse kërkesa pranohet, pika e kontaktit duhet të përcaktojë sasinë dhe nivelin e informacionit që duhet të japë. Informacioni do të kufizohet vetëm në atë që pikërisht kërkohet për qëllimet e kërkuesit, pa rënë ndesh me nenin 8 të urdhrit të ministrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil". Informacioni që nuk lidhet me pajisjet, operimet dhe fushën e aktivitetit të kërkuesit, jepet vetëm në formë të papërpunuar, përveç rastit kur kërkuesi paraqet një justifikim të detajuar.
3. Palët e interesuara të listuara në aneksin I (B) të kësaj rregulloreje, mund të pajisen vetëm me informacionin që lidhet me pajisjet, operimet ose fushën e aktivitetit të palës së interesuar.

Neni 10
Vendimet e natyrës së përgjithshme

Pika e kontaktit që merr një kërkesë nga palët e interesuara sipas listës në aneksin I (A) të kësaj rregulloreje, mund të marrë një vendim të përgjithshëm për t'i dhënë informacion rregullisht asaj pale të interesuar, me kusht që informacioni i kërkuar të ketë të bëjë me pajisjet, operimet dhe fushën e aktivitetit të vetë palës së interesuar.

Neni 11
Përdorimi i informacionit dhe konfidencialitetit

1. Kërkuesi duhet të përdorë informacionin e marrë vetëm për qëllimin e specifikuar në formularin e kërkesës, që duhet të jetë në përputhje me objektivat e parashtruar në nenin 1 të urdhrit të ministrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil". Kërkuesi nuk duhet ta zbulojë informacionin e marrë pa një leje me shkrim nga dhënësi i këtij informacioni.
2. Kërkuesi duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e duhur për informacionin e marrë.

Neni 12
Regjistrimi i kërkesave

Çdo pikë kontakti duhet të regjistrojë çdo kërkesë që i vjen dhe veprimet që ka kryer për të. Ky informacion i transmetohet Komisionit Europian, kur merret dhe/ose shqyrtohet një kërkesë.

Lista e përditësuar e kërkesave që vijnë dhe veprimet përkatëse të kryera nga pika të ndryshme të kontaktit të autorizuara dhe nga Komisioni vetë do t'u vihet në dispozicion pikave të kontaktit.

Neni 13

Mjetet e shpërndarjes së informacionit

Pikat e kontaktit mund t'u japin informacion palëve të interesuara, në formë të shkruar ose duke përdorur mjete elektronike komunikimi.

Për arsye sigurie, palëve të interesuara nuk mund t'u ofrohet akses direkt në bazën e të dhënave që përmbajnë informacionin e marrë nga shtetet anëtare të BE-së, bazuar në nenin 6/1 të urdhrit të ministrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores, për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil".

ANEKSI I

LISTA E PALËVE TË INTERESUARA

A. Lista e palëve të interesuara që mund të marrin informacion bazuar në vendimet rast pas rasti sipas nenit 9/2 të kësaj rregulloreje ose në bazë të një vendimi të përgjithshëm sipas nenit 10 të po kësaj rregulloreje.

Prodhuesit. Dizenjuesit dhe prodhuesit e avionit, motorëve, helikave dhe pjesëve e pajisjeve të avionëve; dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe përbërësve të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA); dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe përbërësve të Shërbimeve të Lundrimit Ajror (SHLA), dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe pajisjeve të përdorura në pjesën ajrore të aerodromeve.

Mirëmbajtja. Organizatat e përfshira në mirëmbajtje ose kontroll të jashtëm fizik të avionëve, motorëve, helikave dhe pjesëve e pajisjeve të avionëve; me instalimin modifikimin, mirëmbajtjen, riparimin, revizionim, kontrollin e fluturimit ose inspektimin e shërbimet ndihmëse standarde të lundrimit ajror, ose mirëmbajtjen, revizionin e sistemeve të pjesës ajrore të aerodromeve, përbërësve dhe pajisjeve.

Operatorët. Linjat ajrore, operatorët e avionëve, shoqatat e linjave ajrore dhe operatorëve, operatorët e aerodromeve dhe shoqatat e operatorëve të aerodromeve.

Ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror dhe siguruesit e funksioneve specifike të Menaxhimit të Trafikut Ajror.

Ofruesit e shërbimeve të aerodromëve. Organizatat e ngarkuara me shërbimet në tokë të aeroporteve, përfshirë furnizimin me lëndë djegëse, përgatitjen e dokumentacionit, ngarkimin, *de-icing* (pastrimin e akullit) dhe rimorkimin e avionëve në një aerodrom, sikundër edhe operimet e shpëtimit dhe zjarrfikëset, ose shërbimet e tjera emergjente.

Organizatat e trajnimit në aviacion

Organizatat e shteteve të huaja, joanëtare të ZPEA-së. Autoritetet shtetërore të aviacionit dhe organizatat e investigimit të aksidenteve nga shtetet e huaja, joanëtare të ZPEA-së

Organizatat ndërkombëtare të aviacionit

Kërkim-studimi. Laboratorë kërkimi publikë ose privatë, qendra ose entitete, ose universitete të angazhuara në kërkime ose studime për sigurinë ajrore në aviacion.

B. Lista e palëve të interesuara që mund të marrin informacion, bazuar në vendimet rast pas rasti, në përputhje me nenin 9/3 të kësaj rregulloreje.

Pilotët (mbi baza personale)

Kontrollorët e trafikut ajror (mbi baza personale) dhe staf tjetër i MTA/SHLA-së që kryen detyra që lidhen me sigurinë ajrore.

Inxhinierë/teknikë/personel elektronik për sigurinë në trafikun ajror/menaxherë aviacioni (aerodromi) (mbi baza personale).

Organizata përfaqësuese profesionale të stafit që kryen detyra lidhur me sigurinë ajrore.

ANEKSI II

KËRKESË PËR MARRJEN E TË DHËNAVE NGA BAZA EUROPIANE E TË DHËNAVE TË NGJARJEVE

1. Emri:
Funksioni/pozicioni:
Shoqëria:
Adresa:

Tel.:

E-mail:

Data:

Natyra e biznesit:

Kategoria e palës së interesuar, së cilës i përkisnin (shiko aneksin I të kësaj rregulloreje):

2. Të dhënat e kërkuara (lutemi të jeni sa më specifikë të jetë e mundur në kërkesën tuaj duke treguar periudhën/datën përkatëse për të cilën jeni i interesuar):

3. Arsyeja për kërkesën:

4. Qëllimi për të cilin do ta përdorni informacionin:

5. Data sipas së cilës kërkohen të dhënat:

6. Formulari i plotësuar duhet të dërgohet me postë zyrtare ose elektronike tek: (pika e kontaktit e autorizuar):

7. Aksesi te të dhënat:

Pika e autorizuar e kontaktit nuk është e detyruar të vërë në dispozicion çdo të dhënë të kërkuar. Këtë mund ta bëjë vetëm nëse është e sigurt që kërkesa është bërë në përputhje me urdhrin e ministrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil". Kërkuesi merr përsipër që ai dhe organizata e tij do t'i përdorin të dhënat e marra vetëm për qëllimin që kanë përshkruar në pikën 4 të këtij aneksi.

Duhet marrë në konsideratë që të dhënat e siguruara në bazë të kësaj kërkese, janë vënë në dispozicion vetëm për qëllimet e sigurisë ajrore dhe jo për qëllime të tjera, përfshirë përcaktimin e fajit ose të përgjegjësisë ose qëllime tregtare.

Kërkuesit nuk i lejohet t'i zbulojë askujt të dhënat e marra pa miratimin me shkrim të dhënësit të informacionit. Mosplotësimi i kërkesave të mësipërme mund të çojë në mohim të aksesit për informacion të mëtejshëm nga *data base* kombëtar i ngjarjeve, si dhe në ndonjë sanksion sipas rastit.

8. Data, vendi dhe firma.